



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 187, Datë 21.07.2022**

**MBI**

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË DIGËN E QYRSAQIT, HEC  
“VAU I DEJËS” I SHOQËRISË “KESH” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 16 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 8 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; të nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.1144/9 prot., datë 20.07.2022 të Drejtorisë së Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kualifikimin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës” i shoqërisë “KESH”sh.a”,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 912 prot., datë 13.06.2022, shoqëria “KESH” sh.a., ka paraqitur në ERE një kërkesë për kualifikimin e impiantit fotovoltaik në digën e Qyrsaqit në HEC “Vau i Dejës” si impiant gjenerues i energjisë së rinovueshme.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar tërësisht.
- Në mbështetje të këtij parashikimi, iu drejtua Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. me shkresën nr. 912/1 prot., datë 22.06.2022, me kërkesën për të paraqitur në ERE raportin e komisionimit të Centralit Fotovoltaik të Digës së Qyrsaqit, në HEC-in e “Vaut të Dejës”.
- Në përgjigje të sa më sipër, OST sh.a. me shkresën nr. 4026/1 prot., datë 28.06.2022, protokolluar në ERE me nr. 912/2, datë 29.04.2022, ka bërë me dije se impiantit i Digës së Qyrsaqit është energjizuar në datën 13.05.2022 në zbarrat 10 kV në N/st 220/110/10 kV të “Vaut të Dejës” dhe ka përcjellë bashkëlidhur edhe përgjigjen finale të inspektimeve të grupit të punës, nga e cila rezulton se është miratuar energjizimi i impiantit fotovoltaik në Digën e Qyrsaqit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të kualifikojë impiantin fotovoltaik në Digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, të shoqërisë “KESH” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**